



**Niko Rapi: na takon neve si gjyqtarë që çdo ditë të vemë nga një tullë në ndërtesën e Drejtësisë!**



Lexoni në faqen 3-4

**Aktualitet**

**Dritëro Agolli**

**-Dr. Honoris Causa**

Në 80 vjetorin e ditëlindjes së tij Dritëro Agolli nderohet me titullin “Doctor Honoris Causa” nga universiteti “Fan Noli” i Korçës, titull të cilin ia dorëzoi personalisht rektori i këtij univesiteti Prof.as.dr. Gjergji Mero. Personalitete dhe akademikë të mbrurit nga Tirana dhe Prishtina vlerësuan kontributin kulturor që ka dhënë Dritëro Agolli në letërsinë shqipe. “Vetë shkrimtari i njohur në fjalën e tij ka përcjellë falenderimet për këtë titull që i është dhënë nga Korça e cila sipas tij mbetet një prej dashurive më të veçanta”. Agolli më pas falënderoi stafin drejtues të universitetit për vlerësimin. I emocionuar nga ky titull, ai tha se e ka marre atë në momentin e duhur të jetës pasi është 80-vjeçar dhe nuk ka kohë të turpërohet. Gjatë zhvillimit të aktivitetit është realizuar një simpozium shkencor lidhur me veprën e Dritëro Agollit ku u lexuan 17 kumtesa.

Intervista në faqen 5-6

**Aktualitet**

Nga Dhimitër Gegprifti

**Integrimi dhe “Faji” në politikën shqiptare**

**Aktualitet**

**Të shkosh në Pogradec për turizmin familjar...**



Lexoni në faqen 8-9

**Poetët në faqet e Nositit**

1. Dhimitër Pojanaku
2. Shpend Sollaku Noe
3. Vangjush Ziko

**Është koha për KASH**

**SOVIETE GENERALE ALBANIA**



Kredi Antone - Shërbimi në Euro

**6.9%**



Lexoni në faqen 6,7,12,13

Nga Dhimitër Gegprifti

# Integrimi dhe “Faji” në politikën shqiptare

Në vitet e Demokracisë për politikën shqiptare të majtë apo të djathtë prioritetet madhore kanë qenë të njëjta. Nëse do t'i veçonim dhe t'i nënvizonim si arritjet më madhore të këtyre dy dekadave, ato janë: futja në NATO, Liberalizimi i vizave dhe fitimi i Statusit të Vendit Kandidat për në BE me çeljen e negociatave për anëtarësim.

Pavarësisht përpjekjeve dhe kontributeve reale të mazhorancave apo opozitave, pa harruar kohën dhe vështirësitë gjatë këtyre proceve, u bë e mundur që sot Shqipëria të jetë anëtare e NATO-s dhe shqiptarët të lëvizim lirshëm në të gjithë hapësirën europiane me pasportat biometrike si qytetarë të lirë të këtij kontinenti. Arritje të tilla nuk janë realizuar lehtë. Është dashur punë e përgjegjësi e mbi të gjitha plotësimi në mënyrë periodike i të

gjitha detyrave të pyetësorit të BE dhe ato shtesë dhe një sërë masash e reformash, të cilat përfshijnë gjithë jetën shqiptare, politikën, legjislativin, shtetin e së drejtës, proceset zgjedhore e të tjera. Integrimi i vendit në BE ka qenë dhe mbetet imperativi i politikës, i qeverive, opozitave, por edhe i parlamentarëve, të cilët si njëra dhe tjetra palë: mazhorancë e opozitë kanë shfaqur akuza të ndërsjellta: Qeveri dhe Opozitë për kontributet e njëra tjetrës, bllokim nga opozita apo paaftësi e Qeverisë, sidomos, kur ka patur edhe dështime. 12 tetori 2011, kur Shqipëria (Qeveria, pse jo dhe Opozita do të marrin përgjigjen zyrtare për Statusin e Vendit Kandidat). Sinjalet e këtyre ditëve nga burime të sigurta konfidenciale nga Brukseli për Progresraportin për Shqipërinë, duket se përsëri Shqipëria nuk do ta fitojë, përsëri

mbetëse, vlerësim negativ si një vit më parë. Klasifikohen për rezultate të vlerësueshme Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja, Shqipëria, Kosova. Shkaku: mungesa e një klime politike konsesuale, sipas Deklaratës së Kopenhagenit, ende probleme me korrupsionin, me pronat, mosmiratim ligjesh me votë 3/5 dhe më e rëndësishmja mosplotësimi i 12 prioritetëve të KE, të cilat nuk janë plotësuar as mjaftueshëm, gati 20 përqind. Si zakonisht tani fillon një “luftë” tjetër dhe kjo jo e panjohur për opinionin shqiptar: akuza dhe kundëraakuza me moton kush e ka fajin?!...Qeveria akuzon opozitën, duke filluar nga Brukseli me deklaratën e zj. Bregu, të cilën e përformojë para nisjes. Opozita akuzon Qeverinë për paaftësi! Edhe sikur të përcaktohej saktësisht se kush është fajtori, a do të ishte kjo një zgjidhje për integrimin?, A do

t'i përshpejtonte ritmet?, A do të ishim bindës për Europën?

Natyrisht që PO! Por nëse të dyja palët mazhorancë dhe opozitë do t'i kuptonin dhe vlerësonin seriozisht situatat e vendit e të politikës me tregues konkret në të gjitha etapat e proceset.

Nuk mjafton të thuash se mbaj përgjegjësi apo e ka përgjegjësinë ai. E rëndësishme është të tregosh se si mban përgjegjësi?, Çfarë bën për ta shlyer atë? Edhe këto ditë të fund shtatori 2011 duket se palët qëndrojnë në të njëjtat “llogore”. Opozita ka propozuar një pakt bashkëpunimi me 10 pika me të cilin është hedhur hapi i parë dhe mund të shërbejë si fillim bashkëpunimi, siç e vlerësoi dhe ambasadori i SHBA në vendin tonë Aleksandër Arvizu.

Bashkëpunimi është i vështirë. Të dy palët nuk “tërhiqen” u mungon toleranca.

## TACSO 2: rivlerësime dhe prioritetet për Shoqërinë Civile

Pogradec, 27 shtator, -Zyra e TACSO (Asistenca Teknike për Shoqërinë Civile) për Shqipërinë organizoi një takim konsultativ me shoqata nga Rajoni i Korçës.

Qëllimi i këtij takimi ishte rivlerësimi i nevojave të organizatave të Shoqërisë Civile, si dhe Prioritetet e TACSO 2 për periudhën 2011-2013.

Ishin të pranishëm: zoti Genci Pasko Drejtor i Projektit për Shqipërinë, zj. Alda Duraj Koordinatore e Projektit.

Pas prezantimit të qëllimit të aktivitetit nga z. Pasko u transmetua filmi dokumentar mbi arritjet e projektit TACSO 1.

Zj. Duraj solli një sërë problemesh nga Shoqëria Civile si dhe kërkesat rigoroze të institucioneve evropiane për aplikime për grante. Zoti Pasko

parashtrori një sërë prioritetesh të TACSO 2, duke kërkuar nga organizatat e SHC të parashtrorinë nevojat e tyre.

Gjatë projektit TACSO 1 janë trajnuar mbi 300 shoqata në shkallë vendi. Janë përfitues nga projektet e BE 6 nga 9 të tilla, që kanë aplikuar. Për punën e mirë, në rritje të zhvilluar gjatë gjithë kohës Zyra e TACSO-s në Tiranë është vlerësuar më e mira për rajonin e Ballkanit.

Pjesëmarrësit sollën përvojat e tyre dhe shtruan një sërë kërkesash për të ardhmen, sidomos në fushën e menaxhimit e të realizimit të projekteve.

Nevoja e hedhjes në database e të gjitha shoqatave është një mundësi më shumë për bashkëpunim në të ardhmen.

*Sfidat madhore me të cilat ndeshet Sektori i Shoqërisë Civile kanë lidhje me ndikimin e tyre të limituar në proceset vendimmarrëse, me kapacitetet e dobëta organizative, mungesën e kohezionit në të gjithë sektorin, veprimtari të pakta me bazë në komunitet, dhe mangësi në krijimin e rrjeteve rajonale.*





Mesazh drejtuar gjithë kolegëve të mi këtu dhe më tej në të gjithë Pushtetin Gjyqësor

## Inaugurohen punimet e gjykatës së re

*Pogradec, -* Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Pogradecit dhe banorët e këtij rrethi data 3 tetor 2011 shënoi një ngjarje me rëndësi. U organizua ceremonia për të inauguruar fillimin e punimeve për rikonstuksionin e godinës së ish-sh Shtëpisë së Oficerave në godinë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në këtë ceremoni mori pjesë Ministri i Drejtësisë zoti Eduard Halimi. Ishte i pranishëm kryetari i Bashkisë të këtij qyteti zoti Artan Shkëmbi, kryetari i Gjykatës të rrethit zoti Niko Rapi, punonjësit e kësaj gjykate, pjesëmarrës nga publiku, korrespondent të mediave qendrore dhe lokale. Ceremonia u çel me vendosjen e tullave të para nga ministri Halimi dhe kryetari Rapi. Në fjalën e tij Ministri prezantoi qëllimin e këtij aktiviteti, duke theksuar se ky shënon një ngjarje me rëndësi për punonjësit e drejtësisë së këtij qyteti, por edhe për mbarë komunitetin e këtij rrethi. Kjo tregon interesin e vazhdueshëm të Qeverisë për të gjithë sistemin e drejtësisë.

Para një viti përfundam Gjykatën e Korçës dhe tani të Pogradecit, duke i çuar këto institucione në nivelet më të larta europiane, duke rritur efektivitetin e punës së tyre dhe duke krijuar gjithnjë e më shumë kushte shërbimi për qytetarët. Në Tiranë në një sipërfaqe prej 40.000 m<sup>2</sup> në bashkëpunim me BE do të ndërtohet Pallati i Drejtësisë, ku do të përqendrohen të gjithë institucionet e sistemit të Drejtësisë. Aktiviteti u mbyll me pyetje të mediave për çështje të hetimit, të censusit e të tjera.

### Të dhëna të rikonstruksionit:

Leja e ndërtimit: Bashkia Pogradec, me vendim të KRRT nr 53, datë 28.02.2010. Subjekti ndërtues shoqëria "Junik", numër licence NZ1814/5. Fondi limit 59.308.848. Vlera e shpallur fituese 44.269.496. Afati i punimeve 10 muaj. Godina e re do të ketë 4 salla gjykimi (tre civile, një penale), ambiente të plota për shërbime ndaj publikut, 8 zyra për gjyqtarët, zyrë për avokatët, bibliotekë, sallë mbledhje.

Nga: Niko Rapi, Kryetar i Gjykatës, Rrethit Gjyqësor-Pogradec

# Gjykata e Pogradecit drejt standardeve europiane!

Si gjyqtar dhe si drejtues, për mua është kënaqësi që ndodhem sot në një moment të rëndësishëm të historikut dhe të veprimtarisë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në fillimin e këtyre punimeve për godinën e re të këtij institucioni.

Kryerja e këtij investimi është i rëndësishëm, pikërisht, se ndërtimi dhe përshtatja e kësaj godine do të ndihmojë në të ardhmen veprimtarinë e Gjykatës në disa drejtime themelore për ta patur atë në standardet Europiane.

Duke përmirësuar kushtet infrastrukturore, kjo do të na ndihmojë për të ngritur në një nivel më të lartë marrëdhëniet e Gjykatës me median, shërbimet gjyqësore kundrejt publikut, ashtu siç i kërkon koha sot, jo vetëm nga pritshmëria e kërkesat në rritje të çdo individit, por normohet nga rregullorja e miratuar vitin e kaluar nga Ministri i Drejtësisë lidhur me këtë çështje.

Gjykata do të ketë një godinë sipas modelit të studiuar gjatë dhe të miratuar në prill 2011 nga Bordi i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor me të gjitha anët funksionale dhe strukturore. Konkretisht: zona e gjykimit, zona administrative, zona e marrëdhënieve e të shërbimeve me publikun. Gjyqtarët do të kenë kushtet e nevojshme për të respektuar kërkesat formale lidhur me solemnitetin në gjykim, sikundër parashikon ligji i



posaçëm për Pushtetin Gjyqësor dhe Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për këtë aspekt të rëndësishëm.

Përmirësimi i kushteve infrastrukturore do t'i japi mundësi Gjykatës, si institucion, që në një kohë relativisht të afërt të përfshihet në projektet e përbashkëta të autoriteteve shqiptare me organizmat ndërkombëtare, siç është projekti JUST i financuar nga USAID lidhur me "Ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, me qëllim uljen e fluksit për

menaxhimin e çështjeve gjyqësore" si dhe "Regjistrimin audio të seancave gjyqësore", i shtrirë në vitet 2010-2015. Gjyqtarët e kësaj Gjykate do të kenë mundësi që ndryshe nga kushtet e vështira në një objekt të para shumë dekadave, në të ardhmen të tregojnë sjelljen e tyre profesionale

dhe etike në një gjykim, por edhe autoriteteve gjyqësore (Inspektoriateve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë të mikqyrin on line dhe të vlerësojnë sjelljen e gjyqtarëve karshi ligjit për këtë element esencial për imazhin e Pushtetit Gjyqësor.

Performanca dhe cilësia e një gjyqtari nuk janë peng i qendrueshmërisë së një apo disa vendimeve në gjykatat më të larta,

(...vijon në faqen 4)





## Gjykata Pogradec drejt standardeve Europiane

(...vijon nga faqja 3)

por niveli i ankimeve për sjelljen dhe solemnitetin, sjellja joetike, joprofesionale dhe josoleme gjatë një gjykimi apo shërbimi gjyqësor janë element thelbësor për performancën e Pushtetit Gjyqësor në tërësi. Duke krijuar kushtet e nevojshme infrastrukturore, ky investim, që po merr rrugë sot, i shërben kësaj performance. Vetëm një gjyqësor profesionist, me etikën e duhur, korrekt dhe solemn në gjykim, mund të fitojë besimin e publikut, mund të jetë i paanshëm dhe aq i fortë sa të përballojë çdo lloj presioni dhe përpjekjet nga faktorë brenda ose jashtë sistemit) për ndikime të parregullta.

Forcimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri kërkon rritjen e besimit të publikut dhe rritjen e nivelit të transparencës, pasi këto janë pjesë integrale e imazhit, që ka ky sistem. Këto aspekte lidhen, jo vetëm me vendimmarrjen, por edhe me dukjen e kësaj vendimmarrje. Me këtë lidhet dhe perceptimi i shumë njerëzve sot, të cilët mendojnë se çdo gjë, që është e mbyllur, është e dyshimtë edhe nëse ka qenë një zgjidhje e drejtë e Gjykatës.

Shpresojmë dhe urojmë që ky investim do të sjellë një Gjykatë më të hapur, më transparente, se pas kësaj do të kemi drejtësi më të besueshme, që është sfida e secilit nga ne dhe e të gjithëve së bashku. Dëshiroj t'u drejtoj një apel të gjithë kolegëve të mi, këtu dhe më tej në të gjithë Pushtetin Gjyqësor: Sot nga Ministri i Drejtësisë po vihet një tullë në godinën e njerës nga Gjykatat, që janë projektuar për infrastrukturën moderne të pushtetit Gjyqësor, ndërsa na takon neve si gjyqtarë që çdo ditë të vemë nga një tullë në ndërtesën e Drejtësisë!

Për secilin individ jashtë Pushtetit Gjyqësor kam të njëjtin apel, të cilin e kam përcjellë më 10 maj të këtij viti, me rastin e Ditës së Drejtësisë: Të nderuar qytetarë! Kërkojeni Drejtësinë vetëm në rrugë të ligjshme! Rugë të mbarë në sfidën e Drejtësisë!

Niko Rapi, Kryetar i Gjykatës, Rrethit Gjyqësor-Pogradec

## Globalizimi i artit publik bashkëkohor shqiptar

Një aktivitet i përbashkët midis Galerisë së Artit Pamor "Lasgush Poradeci", Akademisë Europiane të Arteve dhe Institutit të Arteve Profondiste-ETI, - një ekspozitë kolektive në Pogradec, ku vizitorët u njohën me krijimet e piktorëve nga Gjilani dhe qytete të tjera të Kosovës.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm piktori i njohur ndërkombëtarisht Jetullah Haliti-ETI, i cili ishte dhe nismëtari i këtij aktiviteti. Dëshira e tij për të krijuar lidhje dhe ura bashkëpunimi në fushën e arteve midis komunës së Gjilanit dhe Bashkisë së Pogradecit,

shkon më tej me synim çeljen e një filiali të AEA-së edhe në qytetin e Pogradecit.

Zoti Haliti shoqërohej nga zonja Enkelejda Alushi-Arifi punonjëse në Departamentin e Kulturës në komunën e Gjilanit, ishte i pranishëm piktori i njohur në mbarë hapësirën shqiptare e më gjerë nga familja e dëgjuar Buza, Kujtim Buza e të tjerë. Fjalën e hapjes dhe përshëndetëse e mbajti "Piktori i merituar" Anastas Kostandini (Taso), drejtor i Galerisë së Pogradecit. Përshëndetjet dhe falënderimet personale dhe të zotit Mustafa i solli zoti Haliti, ai i ftoi

për një aktivitet të tillë dhe më të gjerë në Gjilan me artistët pogradecarë, ftesë së cilës iu përgjigj i gatshëm zoti Shkëmbi.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi të tre institucionet kanë botuar një Album të kombinuar me vepra në pikturë, krijime poetike, kritikë arti, shoqëruar me fotot e tyre me autorë kosovarë dhe shqiptarë, ku prezantohet Globalizimi i artit publik bashkëkohor shqiptar, titulluar "Euroart-2011".

Të pranishmit vizituan ekspozitën dhe shkëmbyen mendime të ngrohta midis tyre dhe artistëve nga Gjilani.

### Profili artistik

Akad. Kopy Kyçyku

## Jetullah Haliti- ETI

### sinonim i artit të epërm dhe i ndjeshmërisë së thellë

Krijimtaria dhe përgjithësisht prania e Jetullah Halitit-ETI në botën artistike europiane e më gjerë, si një gërshetim i natyrshëm, për të mos thënë rikthim i mendësisë dhe i dhuntive shqiptare në gjirin e Kontinentit Pla, janë tashmë të njohura e të vlerësuara në nivelet më të larta akademike.

Bashkë me krijues si Kodra, Gjokaj, Kaleshi, Mulliqi, Çavdërbasha e të tjerë më të rinj, në ngjijtje të paprerë, ETI pasuron më tej me artin dhe lartësitë e tij morale, një elitë të mirëfilltë shqiptare, e cila është njëherazi pjesëtare e elitës artistike botërore. ETI është një artist, që i njeh me rrënjë thellinat e shkitshme e jo rrallë të rrezikshme të shpirtit njerëzor dhe, me vetëdijë të plotë e me përkushtim rri i kthyer ndaj Dritës.

Në kushtet e sotme kjo mund të shihet si një flijim i shumëfishtë, që lyp jo vetëm energji të mëdha, por edhe durim, këmbëngulje, mirëkuptim. Lëvizja e tij artistike, të cilën kritika e specializuar e ka quajtur "Profondizëm", mund të shqipërohet "Thellizëm" e kjo jo vetëm si një shqipërim i thjeshtë, por si një afrim më i saktë ndaj thelbit.

Thellinat, thellësitë si kundër vënie ndaj cektinave dhe errësirave përqëndrojnë në vetvete disa nga synimet kryesore të ETI-t, si kumtues dhe shpërndarës i një sasive dhe cilësie të lartë drite mes

njerëzve, mes njeriut dhe mjedisit, mes mikrokozmosit dhe makrokozmosit, mes krijesës dhe Krijuesit. Nga kjo pikëpamje, krijimtaria e ETI-t është përnjimend një mision paqeje. Simbolet që ai përdor e madje ngjiz së pari në veprat e tij, shumica të mbamendshme dhe të denja për titullin "kryevepër", të kujtojnë synime të llojit brankushian. Çdo element i krijimtarisë së tij është në gjendje të "kuvendojë pa vështirësi me thelbet arketipale të bashkëkohësve, pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike, kulturore, gjeografike, historike etj, duke e ndihmuar secilin që të rigjejë veten, rrënjët, kthimin, qoftë dhe të përkohshëm, sa për çlodhje, kthjellim apo mbushje me jone idealizmi: në gjuhën, kulturën, pamjet amtare. Kjo ndodh njëherësh me ngritjen ose me hapjen e shikuesit ndaj universalitetit.

"Rrjetin" e simboleve e mbështet, duke e forcuar dhe qartësuar një gamë e caktuar ngjyrash, të cilat nuk e "fshehin" nga cla epokë vijnë dhe "thonë" mjeshtërisht se cilës epokë ( që është më fort shpirtërore se sa hapësinore e kohore) i drejtohen.

Në një pikë kulmore ngjyrat, simbolet, gërshetimet e të gjithë



elementëve përbërës të një veprë të ETI-t i nënështrohen dhe "punojnë" vetëm për idenë themeltare të veprës, duke e shndërruar këtë të fundit në një akt të mirëfilltë kulturor.

Në një kohë kur gati çdo shprehje e njeriut orvatet dhe shpesh ia del mbanë të trumbetohet si art, kur kitsch-i dhe amatorizmi, që kanë mbështetje mediatike jobindëse dynden nga të gjitha anët, kur arti i epërm dhe i kulluar për nga estetika, mezi çan udhë mes mjegullimit rë vlerave për të mbërritur, sidoqoftë, në paharrim.

Thellizmi i ETI-t përfaqëson si vetiu dhe një nxitje, inkurajim, mbështetje për artistët e talentuar, që sapo kanë hedhur hapat e parë në rruginën plot vegime, magji e gjemba të artit.

Intervistë me Dritëro Agollin

# Qentë endacakë janë të lirë, po kur bashkohen kafshojnë njëri-tjetrin!

Intervistoi: ILIR SHYTA

**Pyetje:** *Si po kaloni në Pogradec?*

-Shumë mirë! Unë e dua shumë Pogradecin! Pogradeci bashkë me liqenin e tij është një nga mrekullitë e vendit tonë ku njerëzit gjejnë një prehje të plotë jo vetëm inaktive, prehje vetëm për t'u shlodhur, por edhe një prehje tjetër që aktivizon imagjinatën, frymëzimin, aktivizon një dashuri të pakufishme për vendin, për njerëzit, për vetë jetën, madje për të ardhmen. Është një vend me ujë, me lule, me zogj, që siç thosh Lasgush Poradeci, veçanërisht kur vjen mbrëmja...

(reciton vargje të Lasgushit)

...Në katund kërcet një portë, në liqer hesht një lopatë

Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal të Thatë

Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im...

Tërë fisi, tërë jeta, ra u dergj e zuri gjumi

Zotëroj më katër anë errësira

Po tashi?

Duke nisur udhëtimin mes për mes nër Shqipëri

Drini plak e i përrallshëm, po mburon prej Shëndaumi.

-Z. Agolli, me sa di unë, ju nuk i jeni ndarë Pogradecit. Keni kaluar muajin e mjalitit këtu me bashkëshorten tuaj Sadien, ndërsa sërish në moshë të thyer, ju jeni i pranguar nga Pogradeci?

-Po këtu, 41 vjet më parë, kur jam martuar, kam ardhur këtu dhe kam bërë siç i thonë muajin e mjalitit. Tashi mua me duket një kohë e largët, por dhe e afërt. Atëherë unë isha i ri (kur je i ri, të duket si një gjë krejt e zakonshme), një diçka që gjithnjë e ke me vete, edhe kur të shkosh diku të duket sikur e mban në xhep këtë gjë, por kur kalon koha, si tashi që unë jam 75 vjet, të hip një mall i madh që atëherë dhe të thërret ky vend. O njeri që ke kaluar këtë kohë të rinisë, hajde dhe një herë tjetër këtu. Dhe unë disa herë kam ardhur për të pushuar, tre-katër vjet me radhë. Por ka edhe diçka tjetër më të largët akoma. Unë kam qenë këtu më 1946. Mësoja në shkollën unike të Bilishtit. Shkollë qytetare ishte dhe kisha një shok të ngushtë



këtu Niko Nikollën. Tani ai ka vdekur. Mund të them që ishte shoku im më i ngushtë, por edhe një nga njerëzit që nuk jam shkëputur gjithë jetën. Unë kam pasur edhe shokë të tjerë, por disa janë larguar për arsye të ndryshme, por me Niko Nikollën kam qenë shok derisa vdiq.

Në '46-ën erdhëm ne nga shkolla e Bilishtit këtu në shkollën e Pogradecit. U takuam, u miqësuaam dhe që atëherë mbetëm shokë të ngushtë. U lamë edhe në liqen.

Kështu me Pogardecin kam një lidhje të drejtpërdrejtë, kurse në lexime jam njohur ndofta kohë më parë kur isha ne fshatin Menkulas nxënës shkolle. Mua më pëlqente Lasgushi, më pëlqente shumë Mitrush Kuteli. Madje po të tregoj një gjë që do të duket çudi. Unë një libër të Mitrush Kutelit "Ago Jakupi" e kam blerë në Bilisht. Librin e kishte një njeri. Atëherë nuk kishte shumë lekë në vitet '44-'45 edhe munda të gjeja një mënyrë për ta blerë. Më dha im atë një torbë me fasule dhe e kam blerë librin kështu me fasule. Domethënë ishte si një gjellë. Pra lidhjet e mia janë të hershme me Pogradecin. Unë atë kohë i mësoja përmendësh vjershat e Lasgushit si fjala vjen "Ikja e shtërgut".

(reciton përsëri vargje të Lasgushit)

...fluturoi dhe shtërgu i fundit Madhështor me shpirt të gjorë...

E bukur shumë. Kështu jam i lidhur shumë me Pogradecin. Këto 3-4 vjetët e fundit të pleqërisë kam ardhur këtu, kam takuar edhe shokë plot, jo vetëm të mitë, por edhe të gruas sime, Sadijes. Ajo ka pasur këtu shumë shoqe si Vaskë Burnazin, Meri Lalajin, Tuke Minarollin...

Z. Agolli, ju pak më parë thatë se Pogradeci është okazion frymëzimi? Keni hedhur ndonjë varg në letër këto kohë në Pogradec ose ndonjë rresht në prozën tuaj gjigande...?

Kam shkruar një vjershë që tani s'e mbaj mend t'ua them. Me tepër mbaj mend poezitë e të tjerëve se sa të miat. Shkruaj për këtë liqen duke e marrë si personazh dhe Lasgush Poradecin, dhe të tjerë, si njerëz që kërkojnë të bukurën në këtë liqen, prej të cilit dalin edhe legjendat. Më duket e kam botuar në librin tim "Gëdhin dhe ngryset". Është një vjershë e gjatë për këtë.

Kam shkruar më parë për Mokrën, për Maro Potkozhanin, për Meken, për Muharrem dhe Rreshit Çollakun...

Edhe tani kam diçka në dorë në lëmin e poezisë, sepse Pogradeci është një vend që të frymëzon, që të

jep mundësi të madhe dhe të ngacmon trurin...

Në fakt një gjë më nevrikos, kur vijnë këtu shpesh njerëz, goftë gazetarë, njerëz të politikës apo të shoqërisë. Menjëherë venë re e thonë që atje panë ca plehra, panë ca ndotësira. Nuk shohin fjala vjen në plan të parë këto bukurira... Është njëllloj si i jep një njeriu të lexojë një tregim që i pëlqen dhe të thotë, po këtë presje nuk e ke venë mirë, domethënë nuk shikon të përgjithshmen, të bukurën. Unë e kuptoj që ka edhe plot mangësira... Po kjo është në të gjithë jetën tonë. Unë në radhë të parë shikoj bukurinë e këtij liqeni, nuk shoh papastërtirat. Kur merret gjithë shtypi do të thonë, ç'të vemë atje? Para katër ditëve isha me një gazetar nga Danimarka. Ishte një miku im i vjetër. Kish ardhur te ne, në Pogradec. Më mori një intervistë për Pogradecin, vendin dhe problemet politike. Ai erdhi të rrinte për pak këtu se do të shkonte në Berat, por i pëlqeu aq shumë sa fjeti këtu. E qirasa edhe me raki e verë buti.

(Ai ishte me të shoqen). E pyeta, -Si të duket këtu?

Edhe im shoq mos rrinte, -më tha ajo, unë do të rrija vetëm dhe do e dërgoja atë në Berat.

Domethënë e kam fjalën që Pogradeci është një vend i bukur, është mëkat që t'i bëjmë me zor disa njolla. Sot në mëngjes unë preva pak veshin këtu. Kush e di si e preva, po më doli edhe pak gjak duke u rruar. Ndofta m'u drodh dora dhe i thashë Sadies, mos e kam gabim që kam prerë veshin. Ndoshta s'është gjak. Mos është vera e Siles që po del nga veshi?

Jo, është gjak, tha ajo.

Jo, moj, i thashë është vera e Siles, se ç'do ajo makina që rruhem të vejë te veshi...

Pra, e kam fjalën është një bukuri e madhe këtu dhe të mos themi gjëra që janë tepër të vogla.

Z. Agolli si e keni njohur zonjën tuaj që mbani në krah prej 41-vjetësh?

Po Sadija ka qenë shumë e bukur atëherë, edhe tani është shumë

(...vijon në faqen 6)



INTERVISTË ME DRITËRO AGOLLIN

(...vijon nga faqja 5)

simpatike nga kjo anë. (Sadija e pranishme në intervistë qesh)

Kjo ishte studente dhe unë gazetar, si ju tani në televizion. Isha i ri dhe punoja te gazeta "Zëri i Popullit". Vija në universitet bashkë me një shok dhe bënim biseda për letërsinë dhe recitonim vjersha. Në atë kohë, në vitet '63-'64-'65-së këto bënim mbrëmje në universitet, siç bënim ne atje në Rusi, sepse unë kam mbaruar studimet në Petërburg. Dhe unë kërceja, loja me Sadien. Nuk kërceja mirë. Ndërsa i shkelja shumë herë këmbën Sadijes, i thoja më fal.

Kjo më thonte (drejtohet nga Sadija), mos më shkelësh ndonjë gjë tjetër, po këmbën mirë. Dhe qeshnim të dy. Kështu lindi njohja jonë, pastaj u dashuruam dhe kemi mbetur të dashuruar edhe tani. Sadija më pëlqente shumë edhe pse e kisha hundën e madhe. Ziheshim ndonjëherë shumë pak.

Z. Agolli, vitet '90 e këtej i keni etiketuar "shkërdhatokrati". I mbeteni sërish këtij mendimi?

Ka periudha të ndryshme. Një periudhë mund të jetë siç e kam thenë unë përpara, një tjetër jo. Nga '91-shi e deri tani kemi një ashpërsim të madh të luftës politike. Asnjëra forcë nuk gjen një pikë të përbashkët. Të gjitha janë në ekstrem të tyre.

Edhe një gjë që është e vlefshme për një forcë politike reale, tjetra (forca politike) nuk e pranon. Fjala vjen, janë bërë rrugë, autostrada... në këto tetë vjet, por forca tjetër s'i pranon. S'është bërë gjë thotë. Fjala vjen në '92-'93-shin, kohë kur u bë ndryshimi politik, forca tjetër që është sot në opozitë, nuk i pranoi ndryshimet e bëra. U dhanë shtëpitë, apartamentet, u bë privatizimi... Kjo meritë nuk i jepet PD-së...

Ose liria e mediave. E kam fjalën që ndryshe duhet ta mendojmë këtë gjë dhe ndryshe duhet të luftojnë këto forca politike. Ato duhet të mendojnë me alternativa. Cila është më e mira për ta çuar vendin përpara... dhe të mos i përvetësojnë gjërat dhe të thonë: Atë që e bëj unë, nuk e bën dot ti. Ne bëjmë kaq dhe ti ke bërë kaq...

Ky mbetet një nga problemet tona më të mëdha të pluralizmit. Ende nuk e kemi kulturën e demokracisë. Kulturën që të jemi edhe tolerantë, edhe xhentilë, sidomos kur ndërrojmë qeveritë. Të shkojë tjetri dhe t'i japë dorën, bravo të qoftë, tani ti fitove. Jemi si kalorësit e 500-600-vjetëve të mesjetës, që edhe bënin duel, edhe i jepnin dorën njëri-tjetrit.

# Vangjush Ziko në dy kontinente

Nga Ilir Buzali

Në 80-vjetorin e lindjes, Vangjush Ziko na befason përsëri me botimet e tij më të fundit: përmbledhjet poetike "Kulla ime e Babelit" dhe "Këtu pranë polit të botës", krahas vëllimit "Monologu i ajsbergut" me krijime të vitit të kaluar. Përshtypja e parë që të krijohet nga leximi i këtyre vëllimeve është se poezia e Vangjush Zikos e ka zanafillën nga ajo shtëpi e qetë në Korçë, në faqe të kodrës; vijon me takimin me poezinë e madhe ruse në vitet e tij studentore dhe tani së fundi me emigrimin në Kanada, për t'u kthyer e rikthyer tek qyteti i lindjes.

Kredon poetike autori e shpalos që në faqet e para të vëllimit "Kulla ime e Babelit". Ai mendon së pari për trashëgiminë që lë pas poeti: "E di./ Një ditë ky gjak i vyer./ Do ngrijë. Do mbeten shtigjet e shkretë./ Por do të rrjedhë gjak i tyre/ Njëpër damarët e kësaj letre." Kurse në një poezi tjetër shkruan "Eshtë absurde vdekje" e poetit./ Jetëvdekja e tij është eterne."

Në ciklin "Unë njeriu" shpalosen marrëdhëniet e poetit me botën, me Zotin, me të tjerët dhe me vetveten. Njëpërmyjet kontrasteve të fuqishme zbulohet një botë shpirtërore e ndërlikuar, kontradiktore, siç është vetë jeta: "Unë i dituri dhe i padituri./ Unë i pasuri dhe i varfëri./ Unë i thinjuri dhe i mituri./ Unë i ndoturi dhe i pastërti./ Zemërbushuri/ dhe zemërbrazuri." Ka edhe një të vërtetë të madhe në këto vargje që shprehin thelbin e botës së Vangjush Zikos; atij çuditërisht s'i shkon fjala "i moshuar". Në një moshë tashmë të pjekur, e shikon botën nga lartësia e 80 viteve dhe njëkohësisht

vazhdon të shkruajë poezi prej 60 vitesh, me energjinë, frymëzimin

"Gratë/ shtruan shpejt e shpejt çarçafët/ tëhollë petkat./ thërmuan trahanët/ energjinë e netëve të ngrira." Këtë motiv e hasim në poezitë "Luftëtari kombëtar", "Mësonjëtorja e luftëtarit", "Vjeshta e Mios", "Skërka e Drenovës", "Mademi i shtufit", "Guri i Polenës" etj. Autori e plotëson kuadrin e botës së tij me poezitë kushtuar nënës, si dhe bashkëshortes së tij Vilma ("Vitet na ikin. Dot s'i mbajmë/ Hirushja ime zemërbutë./ T'i puth ngadalë unë sytë.")

Bota poetike, që nis nga njerëzit më të afërm, zgjerohet përtej kësaj qendre si rrahët koncentrikë, në qytet, rrethina, duke shkuar deri në përmasa kozmike: "Dritat e tokës" "Kometa", "Apokalipsi". Në këtë univers krijues që zë fill në periudhën ruse, vazhdon me jetën në vendlindje dhe me periudhën e emigracionit në Kanada, poeti duket shpesh

i tërhequr nga një element i përbashkët: bora. Në vëllimin "Këtu pranë polit të botës", ku përmbledhen poezitë e periudhës kanadeze autori shkruan: "Ç'më kujtoi vitet e largëta./ Ato vite si mjelma të bardha./ Ç'më kujtoi/ Liqen e Çajkovskit/ në Teatrin e Madh të Moskës..."

Këndvështrimi poetik është zakonisht një dritare e hapur përballë botës së madhe. Vjeshta dhe dimri mbeten stinët e mishëruara në poezi. Në këtë vëllim ndjehet gjithashtu një motiv frekuent, poetinjeri dhe poeti emigrant. Ai krijon me jetën e emigrantit, që jeton midis vendlindjes dhe vendit të emigrimit, imazhin e verores dyngjyrëshe, të përbërë nga dy fije: "Jeta ime/ gjalm i shpleksur./ Mundohet më kot/ të mblidhet./ Pret ditën e verës të feksë/ Verorja e re të dridhet./ Në dorën e nipit/ Të varet verorja






dhe zellin e një adoleshenti të përjetshëm.

Mjeshtëria e tij poetike tashmë është përsosur; ai e zotëron vargun, metrikën dhe vargëzimin, duke e kthyer shpesh në një lojë dëfryese xhonglimi që të mahnit: "M'u drodh dora./ U pengova./ Shkau pasqyra./ Ra fytyra./ Krisi rruga. Plasi syri. U ça buza/ Zgjata dorën./ Dot s'e mblodha./ U gjakosa./ Sozin' tim varrosa."

Herë-herë një varg i shkurtër, plot nerv, shpreh edhe gjendjen emocionale të poetit. Kështu në poezinë "Shqiponja" ai thotë mes të tjerash: "Shqiponja në sy/ po më sheh/ me përçmim./ Ula sytë/ përdhe./ Nuk flas./ Shpirti im/ psherëtin/ në kafaz."

Korça me elementet e saj poetikë gjendet shpesh në krijimet më të reja të Vangjush Zikos, si atmosferë dhe si objekt adhurimi e nostalgjie.





## Vangjush Ziko në dy kontinente

dyngjyrëshe e gjyshit.”

Poezia e bën emigrantin të ndjehet njeri edhe atje, në vendin e huaj, larg vendlindjes. (“Këtu askush s’më njih/ (Pse të gënjej)/ Asnjeri./ Shkruaj të ndjehem Njeri...”) I ndodhur në rrethana të tilla, edhe pamjet e vendbanimit të ri, i transformon në fantazinë e tij, me imazhet e dashura të shtëpisë së dikurshme. (“I drejtë trugu i autostradës,/ Si kumbulla edhe si pjergulla/ Degët ka nderë nëpër tajgë.”) Dhe më tej, autori e sheh aguliçen e Moravës tek pragu i portës, pranë Polit të Botës”.

Një thirrje njerëzore mbyll poezinë “Emigranti”: “Me torbën e punës pas shpine,/ Lereni emigrantin/ të ëndërojë lumturinë.” Këtë ide e përcjell edhe më tej në poezinë pasardhëse “Quhem njeri”.

Që të shkruash poezi të tilla të ngrohta e të ndiera, duhet që patjetër të jesh njeri që përjeton me të gjitha shqisat, me çdo qelizë, dhimbjet dhe gëzimet e botës. Vangjush Ziko të krijon ndjesinë se në poezitë e tij rrotullohet globi i

tërë, ndërsa ai jeton mes dy kontinentesh: në vjeshtë e trishtë, në vendin e “gjetes së kuqe të panjës”, (“Këto mëngjese,/ Kanadeze./ Trupin ma ngjethin”); i përcjellë me një dimër të bardhë, me borën shpesh të ndotur. Pas pranverës, vjen vera, ose rikthimi në Shqipëri, duke mbartur me vete në këtë endje të përjetshme, poezinë. Sigurisht, duke kujtuar metaforën e “verores”, ajo s’mund të kuptohet pa thurjen e fillit të bardhë, me fillin e kuq: e tillë është sot jeta e poetit.

Dy vëllimet me poezi të Vangjush Zikos janë botuar nga Shtëpia Botuese “DIJA Poradeci”, nën kujdesin e redaktore Afroviti Gusho dhe korrektore letrare Vilma Ziko.

**Shënim:** Sapo e mbarova këtë shkrim dhe po e dërgoja në adresën e gruplistës “Bota e re”, mësova se Vangjush Ziko, këto ditë, ndërsa kthehej nga Shqipëria për në Kanada, kish shkruar gjatë udhëtimit me avion edhe tre poezi të reja. Komentet janë të tepërta.





# Të shkosh në Pogradec për turizmin familjar...

*Tushemisht*, -Shoqata "Unë, Gruaja" nisi seancat e trainimeve të fokusuar në zhvillimin e turizmit familjar. Këto trainime realizohen në kuadër të projektit "Gratë bashkëpunim ndërkuftar për ndryshim", financuar nga Bashkimi Evropian. Target grupi janë gra nga komuna Buçimas që ofrojnë turizëm familjar. Këto gra, për 6 seanca rresht do të marrin njohuri në komunikim, marketing, njohuri mbi vlerat kulturore të zonës, trashëgiminë natyrore, etj.

Në seancën e parë të trainimeve morën pjesë rreth 30 gra të zonës së Tushemishtit. Ky trainim u drejtua nga Prof. Dok. Elfrida Zefi. Tema e trainimit ishte: **Aktivitetet Turistike.**

Gjatë seancës së trainimit, gratë pjesëmarrëse shkëmbyen ide të ndryshme rreth mundësive që ofron rajoni ynë, por gjithashtu diskutuan për problemet dhe vështirësitë me të cilat ato përballen. Ndër çështjet që u diskutuan janë: Si të promovojmë vlerat unike të zonës për zhvillimin e turizmit familjar? Si mundet ne të tërheqim më shumë turistë të huaj dhe vendas? Si ta kthejmë këtë periudhë post krize në avantazh për ne?

Çështje të tjera që u diskutuan gjatë trainimit janë: Roli i një guide në njohjen dhe promovimin e potencialit turistik. Ideimi, synimet, grumbullimi dhe përpunimi i materialit, efektet e guidës turistike, etj.

Pogradeci! Një QYTET, jo si gjithë qytetet e tjerë. Kur shfaqet e rishfaqet në memorje, të dalin para syve si në një ekran gjigand një radhë mrekullish natyrore, që të magjepsin me bukuritë e tyre. Liqeni, një sy i madh i kaltër, i kthjellët e i freskët. Malet përreth qëndrojnë si kurorë. Ajri i freskët i mbrëmjeve, që vjen nga grykat e maleve, bashkë me gurgullimën e ujrave të ftohta, që dalin nga "tetë sylynjarë", nga Topleci i dëgjuar. Ashtu me gurgullima shkojnë drejt liqenit. Rrugët dhe lulishtet.

Mbi të gjitha mikpritja pogradecare e këtyre njerëzve të mirë, që në vite kanë krijuar një traditë të bukur familjare, atë të turizmit familjar, duke e përmirësuar gjithnjë e më shumë. Shtëpitë vila të këtij qyteti, enkas për të pritur, turistë, ambientet e zbukuruara, kopshtet me lule e pemë, e bëjnë edhe më të madhe kërshërinë për të pushuar në këtë qytet. Do të shijoni gatimet tradicionale të peshkut e të pastërmave, të lakrorëve e shumë të tjera.

Nuk do t'ju mungojnë verërat dhe rakitë, por edhe gatimet Ballkanase dhe Evropiane. Çdo ditë e më shumë turizmi familjar përmirësohet, guidat turistike shtohen, gratë promovuese për traditën, trashëgiminë kulturore e natyrore me cilësi më të lartë shtohen vazhdimisht.

Gjatë trainimit gratë u ndanë në dy grupe pune ku diskutuan secili grup për rëndësinë e prodhuesit dhe konsumatorit. Njëri grup ishte prodhuesi dhe tjetri konsumatori. Qëllimi i ushtrimit ishte që pjesëmarrëset duke prezantuar produktin dhe shërbimin e vet të japin rolin e biznesit të vogël, si motor i mekanizmit të tregut si dhe përparësitë e pritjes konsumatore ndaj produktit turistik.

Një çështje së cilës iu kushtua interes dhe u diskutua ishte: të dimë cilin target grup të tërheqim. Pra duke pasur parasysh pozitën

gjeografike të rajonit tonë, dhe çfarë ky rajon u ofron turistëve (si psh. klima, liqeni, qetësia, ushqimi bio, tradita, etj.) të mundohemi të tërheqim turistët të cilët janë të interesuar për ato çka ofronjmë ne. Kështu psh: moshë e tretë është më e interesuar për klimën e pastër, qetësinë, ushqimin, ndërsa të rinjtë janë më shumë të interesuar për jetën e natës. Atëherë, duke qenë se Tushemishti ofron më pak aktivitete të jetës së natës, të punohet të tërhiqen njerëzit që janë më të prirur pas qetësisë dhe klimës së pastër.

Seanca e parë e trainimit u mbyll me konkluzionin se "Në një shoqëri të gjithë aktorët kanë nevojë të bashkëpunojnë!". Pra të gjitha këto gra, duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe aktorë të tjerë lokalë që të ofrojnë kushte më të mira për turistët, aktivitete dhe variacion për ta.

\*\*\*

Gjatë seancës së dytë të trainimit pjesëmarrëset u njohën me mënyrën "Si të mbajnë llogarinë për biznesin e vogël". Qëllimi i kësaj seance ishte të njiheshin pjesëmarrëset me procedurat e mbajtjes së llogarive, pra të kontabilitetit të biznesit të vogël si të mbledhim koston e përgjithshme për të gjitha produktet që shpenzohen për të prodhuar ose gatuar ushqimet tradicionale, etj. Edhe gatimi tradicional ze një pjesë të rëndësishme të promovimit të turizmit familjar në zonën e Tushemishtit.

Prandaj, pjesëmarrëset mësuan si të llogarisin koston e produkteve që ato u ofrojnë klienteve të tyre.

Ky trainim u drejtua nga Prof. Dok. Alketa Zheku e cila foli më hollësisht për koston apo shpenzimet që gratë pjesëmarrëse duhet të kryenin për të përmirësuar biznesin e tyre familjar. Në përfundim të trainimit, pjesëmarrëset ishin në gjendje të llogarisnin koston e produkteve dhe shërbimit turistik.

**Alda Isallari**





## Gruaja në vendimmarrje: Rriten kapacitetet për rrjetëzim

Korçë, -U mbajt takimi i gjashtë rajonal me temë "Rritja e kapaciteteve të grave për rrjetëzim" në rajonin e Korçës. Ky takim organizohej nga OSCE.

Pjesëmarrësit ishin, gra këshilltare dhe ish këshilltare, si edhe pjesëmarrës nga Shoqëria Civile. Qëllimi i takimit ishte sjellja e përvojave që këto gra kishin pasur gjatë punës së tyre si këshilltare në qytetet përkatëse.

Temat për të cilat u diskutua në këtë takim ishin: Përmbledhja e gjetjeve dhe rekomandimeve të forumeve të mëparshme horizontale dhe vertikale në rajonin e Korçës, reflektim mbi zgjedhjet lokale duke u parë nga perspektiva gjinore, si dhe komente mbi shkollën verore për këshilltare bashkiake dhe komunare të zgjedhura në 2011.

Një raportim nga anëtarët e grupit të punës rajonal u prezantua dhe u diskutua teksti i deklaratës së ardhshme të platformës kombëtare për gratë, si dhe planet për hapat e ardhshëm që do të ndërmerren nga grupi i punës rajonal i platformës Kombëtare për Gratë.

Gjithashtu u bë edhe njoftimi për Konferencën rajonale që do të mbahet në Nëntor 2011.

Gjatë takimit u prezantua një deklaratë, e cila do i dërgohej presidentit të Republikës Z. Bamir Topi. Pjesëmarrëset diskutuan për përmirësimin e kësaj deklaratë.

Në fund të takimit nga pjesëmarrëset të cilat vinin nga shoqëria civile dhe gra këshilltare bashkish dhe komunash të rrethit të Korçës u dhanë disa rekomandime për konferencën e ardhshme që do të mbahet në Nëntor.

**Albana Maxhari**

### Turizmi: Çfarë Ofron Rajoni i Korçës?

Natyre dhe peisazhe atraktive, me male dhe dy liqene të mëdhenj;

Parqe kombëtarë dhe zona të mbrojtura;

Pamje tërheqëse (*shtëpi karakteristike të ndërtuara me gurë, kopshte, peizazhe natyrorë, gjallëri, specie dhe qenie të veçanta, etj.*);

Klimë të freskët e të shëndetshme në verë;

Një nga pak Rajonet për t'u zbuluar në Europë; Ujë mineral (*Dardhë & Vithkuq*);

Vende me interes historik dhe kulturor, si: vendbanime prehistorike, arkeologjike, objekte kulti, etj;

Potenciale për aktivitete sportive (ski në fshatin Dardhë & Voskopojë, peshkim në liqenet e Prespës dhe në atë të Pogradecit, alpinizëm, hedhje me parashutë, etj.);

Ngjarje kulturore dhe fetare lokale; Organizim panairësh, karnavalesh (*si në Polenë*), Serenatën Korçare si traditë e muzikës qytetare tradicionale, etj.;

Punime artizanati, punime dore, druri dhe guri, gatim të veçantë dhe karakteristik;

Është shumë pranë me tregun e Maqedonisë;

## Deklaratë

Ne, gratë e Shqipërisë, të vetëdijëshme mbi faktin se stereotipet gjinore mbeten ende të forta dhe gjerësisht të përhapura në shoqërinë shqiptare, si dhe mbi faktin se pabarazitë gjinore janë veçanërisht të dukshme në sferën e politikës, u bëjmë thirrje të gjitha partive politike, të gjithë zyrtarëve të zgjedhur, të gjithë anëtarëve të Kuvendit, të gjitha institucioneve shtetërore, si dhe strukturave publike në Shqipëri.

1. Të përmirsojnë Kodin Zgjedhor, në mënyrë që të garantohet përfaqësimi i plotë i grave në të gjitha organet vendimmarrëse.

2. Të zbatojnë me rreptësi dispozitat ligjore për Barazinë Gjinore në Kodin Zgjedhor dhe të Ligjit mbi Barazinë Gjinore në Shqipëri, veçanërisht kuotën gjinore prej 30 %.

3. Të zbatojnë kuotën gjinore prej 30 % në listën e kandidatëve për Këshillat Bashkiak dhe Komunalë, si dhe të sigurojnë përfaqësimin e gruas në kuotën 30 % edhe në Këshillat e Qarqeve në të gjithë vendin, kjo e fundit të ketë një parashikim specifik në legjislacionin elektorale.

4. Të aplikojnë kuotën gjinore prej 30 % edhe në listat e partive politike për Kryetar Bashkish dhe Komunash, gjë që duhet të reflektohet edhe në Kodin Zgjedhor;

5. Të sigurohet përfaqësimi real i gruas në kuotën 30 % edhe në Parlamentin Shqiptar, duke përmirësuar parashikimet ligjore (Kodi Zgjedhor), në mënyrë që detyrimisht 1 në 3 të kandiduar për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë të jetë nga gjinia tjetër;

6. Të sigurojnë publikimin e listave të kandidatëve përpara se ato t'i drejtohen KQZ-së në mënyrë që publiku të njihet me emrat e kandidatëve, detyrim ky që duhet të reflektohet edhe në KZAZ-të, në mënyrë që edhe këto të fundit t'i publikojnë listat për t'ju bërë të njohura zgjedhësve respektivë.

7. Të heqin sanksionin ekzistues mbi moszbatimin e kuotës gjinore prej 30 % duke e zëvendësuar atë, si për zgjedhjet për Pushtetin Vendor edhe për ato Parlamentare, me mosçertifikimin e listave në rast moszbatimi të kuotës gjinore prej 30 %.

8. Të parashikojnë aplikimin e kuotës gjinore prej 30 % edhe në komisionet zgjedhore.

Platforma Kombëtare, Gusht 2011

Turizëm qytetar, me lehtësi për konferenca, kongrese, turizëm seminaresh dhe ngjarjesh kulturore, etj.

Ndër Dobësitë të Cilat Mund të Bëhen Pengesë për Zhvillimin në të, Përmenden:

Ø **Ndotja e mjedisit/natyres;**  
Ø **Dëmtimi i pyjeve;**  
Ø **Mjedisi i dëmtuar nga ndërtimet pa lejë** dhe të pahijshme për nga ana vizuale;

Ø **Problemet e transportin,** herë-herë, rrugë të papërshtatshme për kalimin e automjeteve;

Ø **Shënjat dalluese jo të mira** për të arritur në destinacion;

Ø **Problemet e furnizimit me ujë** (rreth Prespës, Linit, etj.);

Ø **Menaxhimi dhe përpunimi i mbeturinave urbane,** derdhja e tyre shpesh në ose pranë liqenesh, lumenjsh, që dëmtojnë mjedisin, ekosistemin dhe resurset natyrorë.

Ø **Sistemi i paorganizuar i grumbullimit të mbeturinave urbane & të ngurta.**

Ø **Problemet e furnizimit me energji elektrike;**

Ø **Numuri i kufizuar i restoranteve karakteristikë,** mungesa e standarteve të larta në shërbim, etj;

Ø **Standartet jo të kënaqshme të mundësive të akomodimit** (në hotele & shtëpi private);

Ø **Problemet e shërbimit** (pak njohuri mbi nevojat & pritjet e miqve, si dhe atë të njohjes së gjuhëve të huaja);

Ø **Mungesa e linjave të orientuara,** pranë qendrave turistike (male, pranë liqeneve dhe fshatrave);

Ø **Mundesia e informacionit për turistët,** nuk ka materiale informuese (atraksione, mundësi, fasilitete). (Vlen të theksohet puna për hartimin e Guides Rajonale Turistike të Korces-organizuar nga Prefektura e Qarkut Korçe)

Ø **Mungesa e agjensive turistike për dhënie me qera automjetesh,** si: makina, motoçikleta, biçikleta, varka, etj.

Ø **Mungesa e organizimit në shoqërimin profesional të grupeve turistike.**

Ø **Marketingu jo-profesional,** shfaqet herë herë si një disavantazh.





## UNIVERSITETI 'FAN S. NOLI' FAKULTETI I EKONOMISE SHPALL HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT

### 1. "MASTER I SHKENCAVE" në ADMINISTRIM BIZNESI NË TURIZËM DHE MIKPRITJE

Fakulteti i Ekonomise Korce, çel per here te pare programin e nivelit pasuniversitar te studimeve' Master i Shkencave' ne specialitetin "Master Administrim Biznesi ne Turizem dhe Mikpritje. Ky program studimi, i bazuar në eksperiencën e krijuar gjatë projektit

Tempus Joint European Project CD-JEP-17121-2002, tek i cili Fakulteti i Ekonomisë ka qënë një prej partnerëve, është miratuar kete vit, nga Ministria e Arsimit te Larte dhe Shkences e Republikes se Shqiperise. Leksionet do të zhvillohen nga profesorë të Universiteteve te Huaja, te Universitetit te Tiranës dhe stafi i profesoratit të Universitetit "Fan S. Noli"Korce

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Pranohen të gjithë ata kandidatë që zotërojnë:

1. - DIPLOMËN "BACHELOR" (sistemi 3 vjeçar), të Fakultetit Ekonomik, të shkollave publike dhe jo publike vendase dhe të huaja.
2. -DIPLOMËN e sistemit 4-vjeçar të Fakulteteve Ekonomike të shkollave publike dhe jo publike vendase dhe të huaja.
3. -Persona që zotërojnë një diplomë të një Fakulteti tjetër jo Ekonomik vendas apo të huaj, publike apo private, pasi të sigurojnë prane Fakultetit Ekonomik nje numer kreditesh ne disa lende te formimit te pergjithshem ekonomik, per te cilat Fakulteti ofron fasilitetet maksimale ne ndihme te aplikanteve .
4. - Preferohen të aplikojnë për këtë program Studimi, studentët me notë mesatare të Diplomes Universitare 7.5 e lart.

Forma e Studimit është me kohë të plotë, duke patur fleksibilitet për zhvillimin e mësimi, gjate fundjaves dhe mbasditeve.

Programi i studimeve "Master i shkencave Për Administrim Biznesi në Turizëm dhe Mikëpritje" ka 120 kredite dhe tarife konkurruese.

**Rregjistrimet kane filluar.Shpejtoni per te fituar.**

**Gjithashtu në këtë vit akademik Fakulteti i Ekonomise ofron Programet e Studimit ne nivelin master profesional si vijon:**

**II- Master Profesional në Financë-Kontabilitet.**

**III- Master Profesional në Administrim biznesi.**

**IV- Master Profesional në Marketing .**

**V- Master Profesional në Turizëm.**

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

1. DIPLOMËN "BACHELOR" (sistemi 3 vjeçar), në Fakultetin Ekonomik, të shkollave publike dhe jo publike vendase dhe të huaja.
2. Persona që zotërojnë një diplomë të një fakulteti tjetër jo ekonomik vendas apo të huaj, publike apo private, pasi të sigurojnë prane Fakultetit Ekonomik nje numer kreditesh ne disa lende te formimit te pergjithshem ekonomik, per te cilat Fakulteti ofron fasilitetet maksimale ne ndihme te aplikanteve .

Forma e Studimit është me kohë të plotë, duke patur fleksibilitet për zhvillimin e mësimi, gjate fundjaves dhe mbasditeve.

Programi i studimeve Master Profesional ka 90 kredite dhe tarifa konkurruese.

Kandidatët e interesuar për këto programe studimi mund të aplikojnë pranë Sekretarisë së Fakultetit Ekonomik për regjistrim prej

ores 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup>. Viti akademik fillon ne datën 2 nëntor 2011.

**Fakulteti i Ekonomise, Universiteti "Fan S. Noli"**

**Dekane: Prof.Dr. Elfrida Zefi**



-shënime kritike për botimin: “Nobel”, laureatët e letërsisë”

# Vështrim ndryshe për Nobelistët e letërsisë

Dhimitër Gegprifti

Prej gati një viti tregut dhe vitrinave të librit u është shtuar edhe botimi i studiuesit të vëmendshëm dhe të kujdesshëm Bujar Balliu, kushtuar “Nobelistëve” të letërsisë. Para së gjithash na duhet të nënvizojmë dhe të theksojmë se është një punë voluminoze në kohë, por edhe në substrat për arsyet, që ne mendojmë, se janë të pakundërshtueshme.

Prej vitesh autorit, studiues i letërsisë artistike, i kish lindur ideja për një vepër të tillë, e motivuar kjo nga ideja tjetër, tejet e rëndësishme, për t’i dhënë lexuesit të gjerë një botim. pse jo një vepër dinjitoze krejt ndryshe në llojin e saj: një manual letrar të 107 Nobelistëve të vendosur kronologjikisht në një hapësirë kohore 1901-2009, duke menduar se do të plotësonte një boshllëk të ndjeshëm të letërsisë me mbledhjen, sistemimin, përpunimin e vlerave të letërsisë botërore në një konceptim ndryshe, jo pa vlera. Autori Balliu nuk e reklamoi shumë veten dhe as veprën para botimit dhe as në procesin krijues, siç bëjnë disa autorë, por hyri në tregun e letrave, u radhit krahas të tjerëve në vitirina, pa prituri, por denjësisht.

Siç duket, në të gjithë aktivitetin e tij krijues, ai është udhëhequr nga thënia e Heminguejt se “është me rrezik për një shkrimtar të flas për veprën, që e ka akoma në duar, sepse kështu, si të thuash rrezikon “ta thajë” atë”. B. Balliu nuk u hallakat për të gjetur apo sajuar subjekte për botime “letrare” në poezi (vjersha) apo në prozë, të cilat janë të shumta në këto vite

tranzicioni. Puna voluminoze në vite argumentohet me studimin e gjerë të literaturës nga më shumë se 102 autorë, botuar për Nobelistët, burimet nga faqet e internetit si dhe leximi i pjesshëm apo tërësor i veprës së tyre, pa të

cilat do ta kish shumë të vështirë, në mos të pamundur realizimin e një botimi të tillë.

Krahas vlerave të përgjithshme të këtij botimi, të veçantën e përbën puna krijuese e autorit për konceptimin dhe strukturën e librit dhe më e rëndësishmja, që vërtet kemi të bëjmë me një krijimtari, që mban firmën Balliu, është përfytyrimi letrar në imagjinatën krijuese të autorit për çdo Nobelist të shprehur në formë të një eseje. Kjo nuk është punë e lehtë dhe kjo, sipas nesh, duhet të ketë qenë më e vështira, por edhe më e suksesshme. Nuk do të bëjmë gabim, nëse mendimet e shprehura në to t’i vlerësojmë si një portet të plotë moral, por edhe me element të portretit fizik, jetësor të tyre, për analogji t’i vendosim me introduktet e Nolit për veprat e përkthyer nga Ai, që shumë kritikë e studiues të kohës i vlerësuan si krijime origjinale të tij. Sa për ilustrim: 1902 Teodor Momsen (Kristian Mathias Theodor Mommsen) Gjermani. Autori Balliu ka krijuar në përfytyrimin e tij imagjinat portretin e këtij Nobelisti në formën e esesë titulluar “Shpirt poetik”

“Si në gjethe dhe në krijim,  
Jo çdo syth çel trëndafil”<sup>3</sup>

Janë vargje të moshës apo të talentit? Poezia zbulonte thesarin e brendësive të zemrës e të mendjes. Por shprjt e kuptoi se ajo do të ishte pjesë e pasionit, por jo pasioni vetë. Imagjinata-nëna e poezisë, do ta shoqëronte në hulumtimet historike. Frymëzimi rinor qëndroi i ndezur për t’u dhënë shkëlqim fakteve dhe argumentave. Ekzaltimi i bëmave përcillej përmes mjeteve të letërsisë. Konturimi i personazheve me detaje përfaqësuese e dorë mjeshtri, i jep momentit historik forcë ndikuese.

Epoka të tëra “kur çmenduria bëhej fuqi dhe, kur njeriu hidhej në humbëtitë të t’i ikur pamendësisë”

3, zbulohen me ndriçim emocional. Historiani i duhet poeti. Saktësia e ftohtë e të parit, ngrohet nga intimiteti i të dytit. Kur historiani rendte pas vërtetësisë së fakteve, kur harrohej pas grumbullimit të ndodhive e marrëdhënieve shkak-pasojë, poeti e drejtonte vështrimin te njeriu, bota e tij, përjetimet, ndjesitë. Historia pranveron me flladet e freskëta të emocioneve. Mes zhegut të historisë, zhurmojnë fate njerëzore. “Ajo është një monument, që ndonëse nuk mund të ketë bukurinë e lëmuar të mermerit, është po aq e gjithëkohshme sa bronzi”<sup>3</sup>. Pas në shekulli e gati një dekadë një shqiptar krijon portretet e majave të letërsisë botërore, jo me penelat e piktorëve, por me intuitën dhe imagjinatën e tij krijuese.


Lexuesi i gjerë tashmë ka në dorë të gjitha majat e letërsisë botërore me të veçantën e tyre të krijimtarisë e të jetës, jetën dhe veprën letrare, por edhe origjinën e çmimit “Nobel”, si dhe medaljen e këtij çmimi për letërsinë, të cilin, jo në pak raste e lidhnin me emrin e dafinës në latinisht “Laurus Nobilis”, si simbol i mënçurisë, si dega e ullirit, gjethja dushkut e të tjera simbole.

Megjithse në masë të vogël, por janë një vlerë më vete, kur autori Balliu ka qëmtuar dhe veçuar vlerësime të Nobelistëve për Shqipërinë dhe shqiptarët, për letërsinë, artin, s h o q ë r i n ë , procesin krijues.

Mbase botimi do të ishte edhe më i plotë, këto

janë vetëm mendime e sugjerime si lexues, studiues dhe vlerësues i letërsisë, nëse Nobelistët mund të shoqëroheshin edhe me fotot e tyre. Pothuajse për të gjithë nuk thuhet se cila është vepra me të cilën është fituar çmimi, e veçantë apo në tërësi dhe nga ajo apo nga ato mund të sillej një pasazh. Nuk do ta quaja mangësi, por si një kërkesë për strukturën e librit, të cilën duhet ta kishin bërë recenzentët, konsulentët, por edhe Shtëpia Btuese “ADA”: Asgjë për potencialin intelektual, letrar, profesional të autorit B. Balliu. Vetëm fotua, emri dhe recenza nuk janë të mjaftueshme.

Pavarësisht mendimeve të shprehura nga ne në këto pak shënime, botimi i parë i Bujar Balliut është një ndihmesë serioze në fushën e letërsisë, plotësoi një boshllëk në këtë aspekt dhe krijoi një vlerë jo të vogël. Edhe për Shtëpinë Botuese është një sukses për botime të tilla, e cila ka treguar kujdes në përzgjedhjen e materialit për botim, në cilësinë e botimit, në konceptimin grafik e të tjera.





# Pojanaku ideon takim poetik për detin

Nga Albert Abazi

E njihja dobësinë e poetit të njohur Dhimitër Pojanaku për detin, por nuk e merrja me mend se poeti do ish edhe i përkushtuar pas tij. “A nuk do ish bukur, më shkruante në një email, të mblidhen poetët në Vlorë dhe të recitojmë poezi detit? Të jetë një takim larg rregullave, larg çmimeve, ku poetët të vetëfinancojnë takimin! Kush nuk do donte t’i blatonte vargje detit nën këmbët e tij”?!  
E kush nuk do jepte okej, kush nuk do punonte për këte ide kaq interesante!

Pojanaku më thosh se takimi duhej të mbahej më 28 Gusht. Unë u thashë ta ndryshonim datën, pasi kisha një obligim. Mos ma lëviz datën më tha poeti liqenor, arsye do u’ a tregoj atë natë ! Dhe kështu, më datën 28 Gusht, ora 19.00 buzë detit në Vlorë, te lokali i Hetem Kurtit, 100 m poshtë “Delfinit” në Ujë të Ftohtë u organizua mbrëmja poetike “Kredo për detin” me pjesëmarrje të poetëve dhe piktorëve. Pritja përkonte me orën e perëndimit të diellit. Ishte një diell i verdhë në të kuq, një bukurie e çmendur që sa të gëzonte aq të rrëqethte! Dielli, do vuaj, tha një poet, rrugës së perëndimit, do gjakoset maleve, honeve... Ne s’levizim, i kthejmë kurrizin, vetëm se e dimë që do lindë nesër!

Meditim i veçantë, indiferencë i njohur prej vitesh... Pasi e lamë diellin të perëndonte dhe t’i jepte Jonit dhe Adriatikut një pamje të rrallë “si për syrin edhe për zemrën”, poetët çelën takimin poetik. Krijuan dhe recituan vargje pafund për detin. Si dhuratë kushtuar një hyjnie ata i falnin vargjet e shpirtit detit.

U çel në hapësirat e lokalit një ekspozitë piktore me motive nga deti e piktorëve të njohur vlonjatë, falë pasionit të piktorit dhe prozatorit të pasionuar Spiro Qirzidhi. Ishin të shumtë mesazhët dhe telefonatat nga miq që nuk morën dot pjesë, sepse e Diela e 28 Gushtit qe e mbushur me dasma. Dasma paçin miqtë tanë të krijimit, se edhe ne për festë u mblodhëm dhe kaluam shumë bukur. Dasmat kishin

lajmëtarë fishëkzjarret ne kishim vargjet!

E kush nuk dëshiron t’i blatojë vargje me valë të kaltra detit?! Takimi u organizua nga poetët miq të detit, Albert Habazaj (Abazi), Kristo Çipa, Meto Hoxha, Avdurraman Meçe e Hiqmet Mehmetaj. Ky grupim artistik u shënua edhe si bërthama e shoqërisë “Miq të Detit”. Veprimtarinë e hapi ideatori dhe drejtuesi i takimit poeti pogradecar Dhimitër Pojanaku, i cili shprehu dashurinë për detin dhe adhurimin për Vlorën. Poeti Albert Abazi recitoi poezinë e tij “Prelud për detin”, krijuar enkas për këtë takim dhe falenderoi Pojanakun, mikun pogradecar, i cili ndërtoi urën që lidh liqenin me detin, Pogradecin me Vlorën, si dikur Lasgushi me Ali Asllanin. Pojanaku recitoi një poezi shumë të bukur për detin. “Pa syrin tonë që të rrok e puth, që të dashuron e sundon, a s’do ishe një Robinson?! A s’do thahashe një ditë”!

“Piktori Spiro Qirzidhi tha: “Uroj që kjo nisme të vazhdojë. Është kuptimplotë që nis në Vlorë. Është simbolike ura poetike Vlorë-Pogradec. Pogradeci ka patur dikur Lasgushin e Mitrushin. Sot ka Pojanakun!

Edhe Vlora ka patur Ali Asllanin, Petro Markon e Fatos Arapin. Sot ka Hiqmet Meçen, Astrit Hajdinin, vellain tim, Nisin (Dionis Qirzidhi), ka Lefter e Kristo Çipën, Vangjel Picin, Albert Abazin, Xhemil Laton, Astrit Xhaferin, Seit Seitin e plotë të tjerë. Vlora ka shkollën e famshme të pikturës me Nestor Jonuzin, Skëndër Kamberin, Ilmi Banin, Agron Dinen etj.

Meto Hoxha reciton poezinë “Gjiri i Vlorës”. Përsëri Pojanaku. Në këtë takim intim shkëmbehen dhe librat poetikë midis autorëve. Vangjel Pici thotë: “Ne detin e kemi një botë të pasur. Bashkë me pasuritë e bukuritë e tij ka dhe drama. Detin, së pari, e kanë privilegj ata që jetojnë pranë detit. Kam shumë poezi. Kë të zgjedh?” dhe reciton poezitë “Guaska”, “Kur ishish të vegjël” dhe “Të jem pjesë e detit”.

Përsëri Pojanaku reciton poezinë e radhës, me veçorinë nga të tjerët se vargjet e tij i mban m e n d përmendsh dhe krijon një atmosferë të këndshme ,miqësore e të singertë.

Vijon Vangjel Pici me poezinë: “Me detin jemi miq të vjetër”. Krijohet një gjëndje mallëngjyese, sepse Meto Hoxha flet për delfinin e detit të Vlorës, njeriun që u rrit me detin, Qamil Gjonzeneli, i cili iku nga jeta vetëm pak ditë më parë. Kristo Çipa thotë çiltër dhe jo pa krenari: “Ne, himariotët jemi të lidhur përjetësisht me detin. Kemi zaptuar shumë dete. Dhe në male kemi hipur për t’u mbrojtur. Edhe mali, edhe deti janë bërë pjesa jonë organike.” Reciton poezinë: “Bukuri që të merr sytë” dhe “Unë jam Damiani i Himarës”. Vangjel Pici reciton një poezi lirike të bukur me vizatimin trishtimor që i bën një pamjeje tjetër detare. Protoganisti Pojanaku na rrëmben me poezinë: “Nuk ka paqe nën ullinj”, shkruar për një fshat të vetmuar të Korfuzit ku era e detin ishte i vetmi trazim në fshat! Stoli Hoxha (Xhaferaj), tepër e nderuar falenderon Pojanakun dhe Albertin për nismën, e përkrah atë, duke dëshiruar një zgjerim sa më cilësor dhe reciton poezinë: “Romancë”, e cila ngjalli shumë emocione të ëmbla. Përsëri Meto Hoxha me një lirikë të nderur e çliron natyrshëm situatën, e sikur po ndihemi si një familje poetike. Gadishulli i Karaburunit, ishulli i Sazanit dhe perëndimi i diellit aq i ëmbël, si i dërguar nga Perëndia bëjnë poet çdo njeri që vjen buze detit, jo me artistët, poetët dhe piktorët. Ndaj ata të ngazëlluar që po kalojnë kaq mirë këndojnë: “Para takimit të poetit me poetin/ S’është gjë takimi



i mbretit me mbretin”!

Piktori Ilmi Bani thotë: Me që s’ja them dot për poezi, dua të shprehem se po bëhem shumë sentimental. Ndihehem shumë mirë në shtëpi kur, në qetësi, për kënaqësinë time dëgjoj muzikë dhomë. Kjo veprimtari më duket si një poezi dhomë. Grekët e lashtë kanë lënë

një thënie: Në det lahen shumë papastërtira, por ai ngelet përsëri i pastër... Respekt për Pojanakun që na nxit të bëjmë këto gjëra të bukura për të madhërishtin det. Këtu, në Vlorë, na zgjon, na mbledh, na emocionon tok me Albertin. Kritiku dhe poeti Avdurraman Meçe, ndërkohë dhe matematikan i spikatur në Vlorë e ndez bisedën herë pas here, duke i hedhur dhe sherbet humori miqësor këtij takim intim me poetët dhe piktorët e dashuruar me detin. Poetët thurin e thurin vargje pa mbarim dhe ia vendosin detit si gjerdanë shpirti për gushë. Mesnata po kalonte dhe Pojanaku nuk na e zbuloi surprizën, përse pikërisht takimi u mbajt më 28 Gusht e jo më 27 apo 30. Bëra sikur e harrova dhe nuk e pyeta. Diçka do kish sepse na gostiste herë pas here me pije dhe “provokonte” shëndete. Jo dolli si në Mokër, por dollira në miniaturë! Mezi na ikej por po kalonte mesnata dhe, ikëm! Kisha një siguri gati matematike që takimi do ndodhte përsëri vitin tjetër, më i bukur, më i gjërë! Këtë siguri ma jepte jo vetem Pojanaku por edhe shkëlqimi i syve të poetëve dhe piktorëve. Edhe deti sikur më thosh “Se mos e lini me kaq”? Mos u mërzisni, unë vonoj pak por di të kthej nderet!


Vlora nuk kishte gjumë! Deti ia përkëdhelte brigjet cep më cep si falenderim për dhuratat që i blatuan poetët!

Antologji poetike nga Shpend Sollaku Noe

# “Atdheu i tjetrit”

DHIMITËR GEGPRIFTI

Viti 2011 për poetin Shpend Sollaku Noe shënon një arritje tjetër në fushën e botimeve me vlera ideore, artistike të një niveli shumë të lartë. Ai boton për herë të parë në shqip, në Sh.B.A vëllimin poetik “Atdheu i Tjetrit”, antologji poetike nga shtëpia botuese Author House. Kjo është një përzgjedhje shumë e kujdesshme nga gjithë krijimtaria në vite në Shqipëri dhe Itali, duke filluar nga botimi i parë “Sfinks”,



“Mbretëria e gjërave të ndaluara”, “Të duartrokasish Kaligolën”, “Me kryq në shpinë për në Galilea”.

Është e pamundur të shijosh kënaqësinë estetike të vlerave të poezisë së Shpend Sollakut Noe, nëse atë nuk e lexon me kujdes. Ajo është një poezi që ofron mesazhe të fuqishme dhe emocione të veçanta dhe lexuesit i duhet një kulturë e gjerë për të kuptuar çka ai përcjell, strukturat e vargjeve, universin e dijeve të tij, por edhe figuracionin poetik mjaft të zgjedhur.

Libri, para së gjithash, pasi e ke lexuar, të bën të mendosh se ke të bësh me një personalitet poliedrik i përmasave jo të rëndomta, i njohur nëpërmjet përkthimeve të krijimtarisë së tij në dhjetra gjuhë të botës deri dhe në Kinë, dhe në vendet Arabe. Noe nuk është vetëm një krijues, por edhe një përkthyes, i cili ka përkthyer nga italishtja në shqip dhe anasjelltas shumë autorë. Për vlerat e poezisë së tij mjafton të shohësh numrin e madh të mediave të ndryshme dhe autorëve që kanë shkruar për të.

Ndër ta Attilio Bertolucci dhe

Stelvio Mestrovich Wotnynski.

Ky botim tregon se poezia shqiptare me poezinë e poetit Sollaku shkon drejt shtigjesh dhe ngjitjesh të reja nga tematikat, stili, llojshmëria e vargjeve dhe strofave, figuracioni etj.

Në këtë botim do të gjeni poezi nga: “Telegram prej varrezës”, poemat “Murus Nostrum”, “Murus Noster”, “Check up Homerit” dhe “Barkodë”

...Për tërbimin e djajve, pas vitesh pagjumësie,  
gjeta më në fund të uruarën faltore.

Braktis përgjithmonë mitet anakronike  
për të pushuar më në fund në paqe.

Tempulli priftëror-  
banka e lakmuar.

Stoli i përunjshëm për t'u ulur  
përballë një sporteli bankar.

I Lartësishmi?

Gjithmonë i Njëjti,  
quajeni nëse doni  
Atpërrjetshmi Euro  
ose më engjëllisht  
Shën Dollar.

Le të lutemi, vëllezër,  
përpara zotit tonë matematik,  
le t'i përulemi titanit bulldozer,  
i vetmi që livelon racat,  
ideologjitet,  
dhe bën të skuqen prej turp  
integralizmat  
dhe Al Qaeda-n.

Nuk shkon më të theremi me  
njeri-tjetrin  
për pretekste të pjella nga  
templarët e gjorë,  
jemi të gjithë bij të të njëjtit  
kult të vlershëm,  
të Klerit Bankeizëm Botëror.

Mos jini kaq naif, si unë, të  
përpiqeni  
e të besoni akoma  
në një tjetër droktrinë  
globale,  
në një tjetër që nuk është  
Lekizmi -  
stridhe që pjell perla prej  
kartës.

Mos jini kaq kokëtulë, si unë,  
të besoni pambarimisht në një  
kozmos paralel  
me këtë të qelburin  
që na poshtëron,  
ku tempulli nuk i ka themelet  
mbi metoritët e ankthit monetar,  
ku muzika nuk titullohet vetëm  
Euribor e Libor,  
ku era nuk është vetëm  
lëvizja e ajrit prej avionëve të  
luftës,  
ku perëndimet nuk linden  
prej reaksionit të uraniumit të  
varfëruar,

ku Enti Suprem,  
e Vetmja e Përhershme,

Vdekja

është Democraci e vërtetë...

Por prej lartësisë së obeliskut  
pigmë  
më pëlcat timpanët  
tellalli  
prej webit:

Shkoni, o njerëz, të zvarriteni  
si horra të kënaqur,  
të puthni duart e të të  
mëshirshmëve Godfathers,  
t'u lëpini këmbët  
administratorëve bankarë,  
të gërvishni gjunjët në kllapi  
drejt Vegimit Hyjnor,  
nën kafkë të kamxhikoni të  
keqen,  
e të inçizoni në shpinë  
gjarpërinj të gjakosur.

E përjetshme Lutja e Shenjtë  
qoftë:

Banka Jonë që je në Tokë...

(Nga poema “Barkodë”, perfshirë në Antologjinë e Sh. S. Noë-së “Atdheu i Tjetrit”, USA, 2011)

## Poezi

DHIMITËR POJANAKU

### Lulet dhe plakat

Largohuni plaka  
Të liga re,  
S' duam të shkojmë  
Me plak nën dhe',

Gremisuni plaka,  
Honeve.

Afrohi plaka  
Të mirka vasha,  
Për djem nën rrasa  
Stolisur vemë  
Me gaz do flemë  
Makabrit shtrat.

Afrohi plaka,  
Të mirka vasha.

### Këshillë mikut

Çoje natën në pyjet e dendur,  
miku im,

Kur të zhveshë të linjtat,  
Tok me pyllin,

Dehu nga bardhësia e saj prej  
qumështi,

sidomos

atje,

ku

ditën fsheh.

Përkëdhelja tekat.

Zbutja kapriçot.

Ruaje nga leopardi i pabesë.

Nëse i bën të gjitha këto miku  
im,

Nesër,

Mëngjezi,

Do ketë fytyrën tënde.



*Parazitët e zorrëve -Familja ka të bëjë shumë në këtë drejtim, ajo duhet t'ju kultivojë edukatë fëmijëve që sa herë të marrin një ushqim për të ngrënë të lajnë duart.*

# Çfarë e rrezikon shëndetin tonë?

Me parazitët të zorrëve do të nënkuptojmë disa lloje krimbash që parazitohen në zorrët e njeriut. Pavarësisht se ato përbëjnë një nozologji më vete, vetë prezenca në zorrët e njeriut dhe toksinat e tyre janë ato që mund të shkaktojnë të tjera sëmundje apo komplikacione që venë në rrezik shëndetin tonë. Por si një organizëm në rritje e sipër këta parazitë dhe sëmundjet apo komplikacionet e tyre bëhen akoma edhe më shqetësues kur bëhet fjalë për fëmijët e vegjël.

Parazitët e zorrëve janë të përhapur pothuaj se në të gjithë botën, por është vërejtur se në ato vende ku niveli dhe kultura higjienike janë më të ulta, ato janë më të shumta dhe më të shpeshta. Kuptohet se infektimi prej tyre bëhet nëpërmjet gojës, e thënë ndryshe me anë të duarve, ushqimeve apo ujit të ndotur. Më poshtë po shtjelloj katër llojet më të shpeshta të tyre.

**Askaridoza:** Është infektimi nga askaridi. Vezët e tij pasi hyjnë në aparatit tretës, në zorrë këthehen në larva, nëpërmjet të qarkullimit të gjakut kalojnë në mushkëri, prej aty dalin deri në laring më pas ato rigëlltiten dhe duke rihyrë në aparatit tretës në zorrë rivendosen për tu shtuar e për tu zmadhuar me përmasa 15-35 cm. Shënjat klinike të infektimit janë; në fazën e parë mund të shfaqet një kollë ngacmuese, sputum me gjak, vështirësi në frymemarie, më pas mund të shfaqen fryrjet e dhimbjet e barkut deri në bllokim të zorrëve. Nëse askaridi depërton në rrugët e tëmthit, dhimbjet e barkut bëhen më të forta dhe mund të shoqërohen me të vjella e zverdhje të lëkurës. Mjekimi bëhet me vermoks, helmintoks, pirvin, albendazol e tj.

**Oksiuraza:** Shkaktohet nga oksiuret që janë nga më te

shpeshtë. Mënyra e infektimit është e njëjtë, por në rastin e oksiureve mund të ndodhë edhe riinfektimi pasi paraziti gjatë natës del për rreth vrimës së jashtëqitjes duke shkaktuar të kruara, kështu pa dashur dhe pa e kuptuar vezët merren me të kruarat. Shënjat klinike më karakteristike sic edhe kuptohe janë të kruarat, e sidomos gjatë natës, e shoqëruar hera-herës me pezmatim të vendit për rreth, madje janë verejtur raste të pezmatimit edhe të vaginës tek femrat. Të tjera shenja, ka dhimbje barku deri në simulim të dhimbjeve të apendisitit, të përzjera, të vjella, gjumë i shqetësuar, shfaqje alergjike. Mjekimi mund të bëhet me vermoks, helmintoks, pirvin pamoat, combaktrine e tj.

**Lambiaza:** Është infektimi nga lambia intestinale. Ky parazit është kaq i vogël sa nuk shihet me sy dhe parazitohet në fillim të zorrës së hollë, gjë që e bën edhe më të vështirë mjekimin e tij. Infektimi ndodh njësoj si në të gjitha parazitozat e tjera, por vërehet më shpesh në kolektiva ku higjiena është në nivele të ulëta. Fillimi i sëmundjes mund të jetë i shpejte ose gradual. Shenjat mund të jenë dhimbje dhe heqje barku, humbje oreksi, të vjella e tj. . Në raste të rrënda ka dalje të furishme diareike dhe shenja të dehidrimit, të mungesës së përthithjes së ushqimeve, anemi e vonësë në rritje). Mjekimi bëhet me flagyl, tibeal, fasigin e zentel.

**Trikocefaloza:** Infektimi shkaktohet nga trikocefali, që është po ashtu një parazit shumë i përhapur dhe merret me anë të duarve, ushqimeve, ujit madje edhe me lodrat e infektuara. Shenjat në format e lehta mund të jenë; dhimbje e fryrje të shpeshta të gjysmës së poshtme të barkut shoqëruar me temperaturë, anoreksi, gjumë i shqetësuar, të kruara, të vjella dhe anemi të

formës së lehtë deri në mesatare. Në formën e rëndë heqja e barkut mund të shoqërohet me gjak e mukus. Mjekimi mund të bëhet me vermoks, zentel, osarsol e tj.


Sa për mjekimin i përket mjekut të familjes që do të vendose, pasi ai jepet sipas peshës trupore të fëmijës dhe detyrimisht pas analizës përkatëse që do të evidentojë llojin e parazitit. Ajo c'ka duhet të dini ju është se si bëhet parandalimi i infektimit prej parazitëve. Masat parandaluese janë fare të thjeshta. Meqënëse fëmijët janë të vegjël dhe presin cdo gjë nga ne të rriturit ato do të ndaja në masa parandaluese familjare dhe shoqërore.

Familja ka të bëjë shumë në këtë drejtim, ajo duhet t'ju kultivojë edukatë fëmijëve që sa herë të marrin një ushqim për të ngrënë të lajnë duart. Zarzavatet të lahen dhe të zjehen mirë. Perimet dhe frutat po ashtu të lahen me ujë të bollshëm e të rrjedhshëm. Të merret çdo masë kundra mizave që të mos kenë mundësi të ndryshë ushqimet. Nëna sa herë që të gatujë apo të shtrojë vaktin për pjestarët e tjerë të familjes të lajë duart. Nëse jeni në fshat, bëni

kujdes me gropat e zeza që të mos krijohet mundësia e infektimit të ujit të pijshëm prej tyre. Mos lejoni fëmijët të luajnë në dhera dhe në afërsi të grumbullimit të plerave. Nëse keni në shtëpi qen apo mace, ata duhet të jenë të vaksinuar e të kontrolluar nga veterineri, përndryshe të mos lejohen fëmijët që t'ju afrohen atyre.

Ndër masat parandaluese shoqërore mund të përmend: Krijimi i tregjeve brenda standardeve higjieno-sanitare dhe të pajisur me ujë të rrjedhshëm e frigorifer. Ndërtimi i ujësjellësave të rregullt e pa çarje. I gjithë personeli shëndetësor herë pas here të zhvillojë biseda rreth parazitëve dhe masave parandaluese. Kur konstatohet një fëmijë i infektuar mos neglizhoni të mjekoni të gjithë pjestarët e familjes. Biseda rreth edukatës dhe masave higjieno-sanitare mund të zhvillojnë edhe edukatorët e kopshteve edhe arsimtarët e shkollave 9 vjeçare. Herë pas here të bëhen fushata për eliminimin apo izolimin e qenëve rrugaçë.

**Dr. Andrea Kocaqi**  
Mjek p./f. Ambulanca  
Libonik, Korçë.



Mitologjia e Antikiteti i gadishullit Ilirik, mbështetje për zhvillimin e turizmin vendor

## Perëndesha e Bukurisë ti je!

I dua vajzat bukuroshe,  
Ju përgjrohëm deri në buzë  
të varrit,  
por është mëkat i madh për  
vdekje,  
të ngrihesh kundër Zeus  
kryetarit.

Robert Bërns, shqipëroi  
Lasgush Poradeci

A e dini se kurora "Perëndeshë e Bukurisë" ka për folezë Enkelanën e Lyknidës.

Njëzet e pesë shekuj më parë ishte qyteza e Enkelanës, qyteti i Pogradecit sot

Vendi mikpritës i një aktiviteti festiv sa kulturor e njerëzor, shumë të bukur e tepër të rëndësishëm që zhvillohej aso kohe në vendbanimin e hershëm në ato brigjet e pellgut ujqor që lageshin nga ujërat e liqenit të Lyknidës. Festime, që hanin dyzet ditë kohë për përgatitjet e shumta dhe finalizoheshin e përmbylleshin gjatë një jave me shpalljen e vendosjen e Kurorës së Artë, Perëndeshës së Bukurisë.

Vet Zeusi ishte i pranishëm në këto festime, Ai vetë, ia vendoste asaj fitueses, atë Kurorën e Artë, atyre që shpallehin, Perëndesha të Bukurisë të gadishullit Ilirik.

Më duhet të kujtoj disa nga ato princesha e mbretëresha të Bukurisë, Ledianës, mëmës së Helenës së Bukur, Arabën të ëmën e mëmës së Pirros, Olimbisë të Neoptolemit, nëna e Aleksandërit të Madh, Mokrena, Partha, Dasara, Teuta, Dhoqina, të cilat datojnë të shek IV p. e. r e me shumë emra princash e mbretër të atyre kohërave pjesëmarrës, "përfitues" e festueses të asaj feste për krejt trevat e gadishullit Ilirik nga të cilët do përmendja, Kurorën e Perëndeshës së Bukurisë, vendosur Ledianës nga Zeusi i cili dhe e hyjnizoi atë dhe të lindurit e saj, Dimitrin, të atin e Filipit me Neoptolemin, Pirron me vajzën e Dasarës së Dasaretëve, Helenën me Minelanë, e shumë princër më pas mbretër, kujtoj Klitin, Glakun, Gentin, Agronin, Langarin, Filipin, Kostandinin e shumë e shumë të tjerë mbretër të kurorëzuar.

Kohëzgjatja e festimeve

vazhdonte, aq ditë sa Zoti krijoi Botën, pa llogaritur kohën e njoftimeve e konfirmimin e pjesëmarrësve, koha prej 40 ditësh ishte përgatitore, gjatë së cilës merreshin e përfundonin të gjitha masat organizative për ato aktivitete që do zhvilloheshin. Aktivitetet më konkretisht ishin këto:

Organizimi i panairëve për veshje, prodhimeve artizanale, produkte bujqësore e blegtorale, farëra e fidana, lëndë të parë e kafshë me vlerë etj. Të gjitha këto, falë lehtësive e sigurisë që ofronte Via Egnatia për pjesëmarrësit, personalitete e trupat e shoqërimin. të tyre, si dhe karvanët me mallra e dhurata të ndryshme

-Familjet e qytetarëve, ishin baza e sistemimit të miqve të ftuar, pa lënë mënjanë, hanet të cilët afronin strehim, ushqim, shërbim e siguri për kuajt, kaloshinat e njerëzit që kujdeseshin për mirëmbajtjen e tyre

Interes besoj ka trajtimi e argumentimi i kohës prej dyzet ditë të përcaktuara. Përse? Sepse edhe pas shumë shekujsh, sot kanë ndikim e tyre, ato mendësira.

Dyzet ditë pas martesës, thonë nuk i duhet dalë "Dhëndërit" përpara. Dyzet ditë thonë gruaja është lehonë pas lindjes, dyzet ditë thonë do mushti të bëhet verë, dyzet ditë duhet mbajtur zi i ndjeri e mbase ka dhe dyzeta të tjera, për të vazhduar më tej me numrin "shtatë", aq sa ditë ka dhe java, kaq ditë iu deshën Zotit për botën.

-Dita e parë fillonte me ardhjen e të ftuarve, ju urohej miqve mirëseardhja dhe bëhej akomodimi nëpër familje sipas radhës e sërës që përfaqësojnë e rëndojnë.

-Dita e dytë ishte e Marta. Njohja me qytetin, tregun, shëtitje në mjediset e tij, njohja me shokët e miqtë e të zotit të shtëpisë dhe vizita midis tyre.

-Dita e tretë - Hapja e festimeve të cilat fillonin me konkurrimi e vashave nga gjithë trevat e kombësitë e gadishullit ilirik, cila do meritojë Kurorën e Artë, atë që komisioni do ta shpallte Perëndeshën e Bukurisë. Vargjet që këndoheshin kanë ardhur deri në ditët tona:

Perëndeshë e bukurisë ti je, / unë pa ty nuk mund të jetoj / dashurinë

që kam shtënë më ty / o bobo si do t'ia bëj.

-Ditën e katërt bëhet shpallja e dymbëdhjetë Princeshave dhe më pas, prej tyre përzgjidhet "Perëndesha e Bukurisë".

-Ditën e pestë, "Pëlqimet" dhe kërkohej dorë e princeshave të hijshme e shumë të fisshme e veçmas e Perëndeshës!

Nga princat e kaltër ardhur prej larg enkas, për këtë njohje e më pas, shpalljen e lidhjeve në fejesë të këtyre princave të vërtetë e atyre princeshave të këndshme.

-Dita e gjashtë, e shtuna, në këtë ditë bëhej shpallja e lidhja në çift, zyrtarizimi e shpallja e këtyre miqësive të lidhura e këmbim dhuratash midis tyre, shëtitje argëtime, dreka e darka si ura lidhëse midis fiseve e popujve nga ky festim ballkanik

-Dita e shtatë e Diela përmbyllëse ishte pa dyshim një eveniment historik Ballkanik.

Kjo ditë përmbyllëse kthehej në një festim mbarë qytetar, ku festohej e pihej!

Festa e pijes së Verës!

"Unë jam festa më e vjetër, ku pihet verë, nga butet e atyre qilarëve, që e ruajnë atë për shokun e mikun, si ruan midhja perlën në fund të deteve e oqeanëve, ku demonstroheshin miqësitë e reja, veshjet, këngët, vallet nga trevat e popujt, si dhe kuzhina, gatimet sipas traditës së tyre ballkanase, të cilat shpesh ndërthuren.

-Për të shpallur kuzhinat e gatimet fituese Koranin e Ngjalat, Bostan Tavat, Gjylbazet, Pastërmarrat, Bërxollat, Lepujt e Kaprojtë, e të tjera gatime të shijëshme të pakrahasuara.

Atje në atë festim, janë të ekspozuara, Vashat me "bandillët" e tyre të parë, pëlqyer e lidhur në martesë, atje në ato ditë festimi përrallore e mbretërore.

Atje tregohej e demonstrohej fisnikëria e bujaria e tyre, të cilët kryesisht ishin dhe "donatorë" të shpenzimeve të këtij festimi ku motivi e mesazhi është i qartë, Miqësi, Mirëkuptim, Bashkëpunim midis gjithë popujve nëpërmjet, Kulturës!

-Vera, kjo pije e jetës, ka për vend origjine këtë pellg ujqor. Hapja e kanellave të buteve me verë



vazhdon edhe sot të pihet në enë balti, bardhaqe, poçe, tasa. buki e lloje e soje gotash e tasash luksi. Në përcjellje miqve, ndër të tjera ju dhuroheshin disa rrënjë hardhie rrushi, simbol i miqësisë, harmonisë e dashurisë.

Që atëhere janë dashur të kalojnë XXV shekuj që historia të përsëritet dhe qyteti i Pogradecit të jetë mikpritësi i Festivalit Ballkanik të filmit e gatimeve, të zhvilluar gjatë periudhës 29 gusht deri 4 shtator.

Koço Pihoni

-poezi-

### Mall për Atdheun

Shqipëri, o moj Shqipëri,  
Sa të dua ty, nuk e di,  
Në zemër gjithmonë të kam ty,  
Kam vite pa të parë me sy.

Dua të vij sa më shpejt,  
Që ty të të kem prap në jetë.  
Në Amerikë unë jetoj,  
Bukurinë tënde nuk e shikoj.

Shqipëri, o moj Shqipëri,  
Vendi më i mirë je ti,  
Je plotë me jetë e dashuri,  
Je e varfër, por e lirë,  
Pa ty nuk ndjehem mirë.

Shqipëri, o moj Shqipëri,  
Unë dua tek ty të vij,  
Jo për shumë, jo për pak,  
Sa të heq atë merak.

Nikolin Angjo



# Je një vajzë e re dhe me ambicje?

Dëshiron të krijosh biznesin tënd atje ku ai mungon?

Mund të promovosh trashëgiminë natyrore e kulturore të rajonit tonë!

## Bëhu një guidë dhe jepu mundësi turistëve të njohin rajonin tonë!

Në muajin Nëntor, Shoqata "Unë, Gruaja", në kuadër të projektit "Gratë bashkëpunim ndërkuftar për ndryshim!", financuar nga Bashkimi Evropian, do të realizojë trajnime të fokusuar në përgatitjen e një grupi vajzash të cilat kanë pasion dhe dëshirojnë të punojnë si guida turistike.

Ftohen vajza të reja që kanë njohuri mbi trashëgiminë natyrore e kulturore të rajonit tonë, të aplikojnë pranë Shoqatës "Unë, Gruaja" për të marrë pjesë në këto trainime.

Për më shumë informacion, të interesuarit mund të kontaktojnë në tel. 222140, e-mail: [une\\_gruaja@yahoo.com](mailto:une_gruaja@yahoo.com)

në Facebook: <https://www.facebook.com/pages/Shoqata-Une-Gruaja/179295668750141>

ose pranë shoqatës "Unë, Gruaja", në adresën: Lgj. 1; Rr. Rreshit Çollaku, Pogradec



This project is funded by European Union

Njoftim

Njoftim

Njoftim

Nëse jeni duke përjetuar një situatë të dhunës në familje, tani ligji ju ndihmon!

**Telefono 22 21 40**

**Këshillim për gratë e vajzat!**  
Ofrojmë mbështetje emocionale!

Ju informojmë për ligjin "Masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare".

Nga e hëna në të premte, ora 9.30-16.00

Shoqata "Unë, Gruaja", Pogradec



Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO

Gazetarë: Dhimitër Gegprifti

Korrespondente: Alda Isallari, Albana Maxhari

Lexoni gazetën në: [www.poradeci.com](http://www.poradeci.com)

Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "DIJA - Poradeci", -Pogradec

Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec

Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753

e-mail: [afrovitig@yahoo.com](mailto:afrovitig@yahoo.com)